

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 616-25-1133-2-1-5 nr. brend.: 616-25-031-2-1-5

Sa i përket tenderit për: Ofrimi i shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave Lot 1 dhe lot 2 kontratë e negociuar

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ANUAR SH.P.K.; MUHAMET MUCIQI; BERISHA COM SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Llashticë e Eperme,

(Adresa)

Llukare,

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044/620-710

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Nazif Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

anuar-shpk@hotmail.com

(Adresa elektronike)

18.04.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ftesa për tenderim: **13.03.2025**

Hapja e tenderit: **17.03.2025**

B058 Njoftimi mb vendimin e AK: **03.04.2025**

Kërkesa për qasje me date: **03.04.2025**

Lejimi i qasjes pjesërisht dhe kufizuese: me date: **07.04.2025** (*pasi AK nuk na jap qasje me date 04.04.2025 dite premte por e shtyen të Henen me date 07.04.2025 duke na kufizuar afatin për pergaditje te ankesese ne shkelje te nenit 10 te LPP-së.*)

Kërkesa për rishqyrtim me date: **08.04.2025**

Vendimni mbi refuzimin e KpR date: **13.04.2025**

Ankesa OSHP me date: **18.04.2025**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Në hapjen e këtijaktiviteti të prokurimit nuk kemi marr pjesë sepse ishte elektronike përmes platformës e-prokurimi dhe konsiderojmë se ka qenë rregull procesi i hapjes.
Por proces verbali i hapjes është ngritur në platformën elektronike

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

AK – ZPP ka Refuzuar KpR, mirepo nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-se par. 8 dhe 12 duke mos arsyetuar dhe duke vazhduar me diskriminim dhe eliminimin duke vepruar në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-se

Mirëpo AK nuk shqyrton pretendimet tona fare vetëm arsyeton se ka respektuar LPP duke mos e trajtuar fare me çështjet e ngritura në pretendimet tona ankimore dhe shqetësimet tona lidhur me këtë aktivitet të prokurimit edhe përkundër që kemi argumentuar detajisht, DUKE OFRUAR PROVA DHE FAKTE KONKRET.

AK – ZPP ka nxjerr vendim në kundërshtim ME NENIN 108/A të LPP-se si dhe në kundërshtim me nenin 59 dhe 60 të LPP0-se krejt kjo është bërë me qëllim të diskriminimit të tone dhe eliminimit të tone nga konkurrenca edhe përkundrazi se ne jemi tenderues i përgjegjshëm me çmimin më të lirë dhe brenda vlerës së

parashikuar nga AK ne dosje tenderit dhe duke pas parasysh pretendimet tona ankimore ne pamundësi per ti kundërshtuar me fakte dhe prova konkrete pasi PRETENDMET tona ankimore kan baze ligjore dhe qendrojn AK – ka zgjedhen formen e refuzimit te KpR pa u mbeshtet ne fakte dhe prova konkret dhe nuk eshte arsytuar ne asnje dispozit ligjore te LPP-se
Pra me fjale tjera AK ka refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim ne kundërshtim me **nenit 108/A te LPP-se** dhe per te mos komentuar dhe ne munges te provave dhe fakteve per shkeljet qe kane ndodhur ne vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, AK është shume i vetëdijshëm për shkeljen e dispozitave ligjore te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES -shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si në vijim:

1. Neni 1 të LPP-së
2. Neni 2 të LPP-së
3. Neni 6 të LPP-së
4. Neni 7 të LPP-së
5. Neni 24 te LPP-së
6. Neni 52 të LPP--së.
7. Neni 56 të LPP--së.
8. Neni 59 të LPP-së
9. Neni 60 par. 1.1 te LPP-së.
10. Nenin 108/A te LPP-se
11. Nenin 134 te LPP-se.
12. Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE
13. Neni 40.6; 40.7 dhe 40.8 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP
14. Nenin 43 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP
- Nenin 45 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejtartifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, me datë **03.04.2025**,përmesplatformës elektronike e-prokurim merr vendim - 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, që do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore te LPP-së, dhe rreg. Nr. 001/20222 për PP te cilat do i argumentoj dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkret si ne vazhdim te kësaj KpR.

Andaj duke marr për baze dispozitat ligjore te LPP-se **ne si OE palë me interesë sipas nenit 4 par. 1.26 te LPP-së,** edhe per kunder faktit se ne kemi kemi arritur te plotesojm te gjitha kriteret e perzgjedhjes te percaktuar ne **Ftesen per tender dhe Dosjese se tenderit,** mirepo AK – Komisioni i vleresimit – ZPP duke shkelur dispozitat ligjore te LPP, duke na elemnuar padrejtesisht, duke ne diskriminuar ne detyrohemi te parashtrojm kerkese per rishqyrtim pran AK duke pasqyruar dhe nje here faktet dhe argumentet lidhur me **shkeljet e LPP-se tek Letra standadrde e elemnimit – arsytimi : Leja MJEDISORE– Leshuar nga po vet AK – Komuna e Prishtines,** te cilat i kemi dorezuar ne platformen elektronike e-prokurm per kete AK me rastin e aplikimit ku argumentohet dhe konstatohet se te gjitha dokumentacionin e kërkuar per këte AP

jane ne pajtim te plote me **Ftesen per tender dhe Dosjese se tenderit**– duke plotesuar ne tëresi kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesor te dhenies se kontrates – çmimi me i ulet i pergjegjsehm.

AK me rastin e eliminimit te kompanise tone GOE per aktiviteti te prokurimit permes njoftimi 058 vendimit mbianulimin e aktivitetit te prokurimit duke na shpallur si OE TE ELEMINUAR. Ne tani po ngisim disa arsyetime KONSTATIME për këtë AP – Procedure te Prokurimit – Procedure e negociuar, si me poshtë:

Pretendimi: 1

Autoriteti kontraktues – komisioni i vleresimit – ZPP ne komunen e Prishtines, me rastin e elnimit permes B42 - letres standarde te eliminimit te dates; **03.04.2025, ne shkelje te nenit 59 dhe 60 te LPP-se dhe nenit 43 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP,(Krejt kjo eshte bere duke na diskriminuar duke vleresuar plote 17 dite nga data e HAPJESE, duke kerkuar sqarime perms letres standard me date 20.03.2025 lidhur me Validitetin e LEJSE MJEDISORE, ku ne ju kemi kthyer pergjigje me date: 21.03.2025 edhe perkunder sqarimit tone I cili ka qene I sikat konkret dhe me fakte dhe argument konkret AK me date 03.04.2025 nxjer B058 njoftimim mbi vendimin e AK dhe Ltreren standard te eliminimit me arsytimin lidhur me LEJE MJEDISORE duke jap arsytimete cilat jane krejt ne kundershitim me kriteret e perzgjedhjes – kerkesat e pershtateshmerise profesionale te percaktuar ne fetsen per tender Andaj ne vijim po theksojm arsytimin e elemnimin ne letren standade te elemnimit te dates 03.04.2025 qe kemi pranuar permes platformes elektronke e-prokurim si ne vijim:**

[Tenderi i juaj] është i papërgjegjshëm

☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

☐ Ju si GOE-ik nuk keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Neni 7.1 & 7.2. Kërkesa: OE-ik duhet të dorëzohet licenca për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leja mjedisore për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga Komuna e

⁶ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Prishtinës). Dëshmia e kërkuar dokumentare: Licensuar për Menaxhim të Mbeturinave ose Leje Mjedisore Komunale për Menaxhim të Mbeturinave. Juve si GOE-ik, AK ju ka kërkuar sqarime shtese të tenderit me datë 20.03.2025 në lidhje me kërkesën e DT-së të lartcekur për Lejet Mjedisore Komunale për Menaxhim të Mbeturinave. Ju si GOE-ik me datë 21.03.2025 jeni përgjigjur sqarimeve të AK-së mirëpo sqarimet e dërguara nga ana juaj nuk kanë qene të pranueshme për komisionin e vlerësimit pasi lejet me NR: 05-352/10-143796/23 të datës 18.08.2023 dhe 05-352/10-81474/23 dt. 18.05.2023 janë në kundërshtim me Rregulloren Komunale 01-030/01-227581/23 për Menaxhimin e Mbeturinave.

Andaj për arsye të cekura më lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të paraqitni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues. Nëse keni vendosur të bëni ankesë, ju duhet të informoni Autoritetin Kontraktues për këtë gjë. Gjithashtu Komisioni i vlerësimit në raportin e tijë jap arsytime si në vijim:

GOE-ik: ANUAR SH.P.K.; Muhamet Muçiqi; BERISHA COM SH.P.K është përgjigjur sqarimeve të kërkuara me datë 21.03.2025. Përgjigjet janë në sistem të e-prokurimit dhe në lënden fizike. Sqarimet e dhëna nga OE-ik për komisionin e vlerësimit nuk kanë qene të pranuar dhe të bindshme për arsye se janë në kundërshtim me Rregulloren Komunale 01-030/01-227581/23 për Menaxhimin e Mbeturinave. Komisioni i vlerësimit konstaton se Oferta e GOE-ik ANUAR SH.P.K.; Muhamet Muçiqi; BERISHA COM SH.P.K është e papërgjegjshme dhe eliminohet për këtë aktivitet të prokurimit.

Keto arsytime të shkruar në letren standadre të elemnimit nga **AK – ZPP komisioni i RIVLERESIMIT** nuk qendrojnë për faktin se Leja MJEDISORE në me rastin e tenderimit kemi dorëzuar Lejen Mjedisore– lëshuar nga vete komuna e Prishtinës dhe kemi plotësuar në teresi duke plotësuar Kërkesat mbi përshtatshmerin profesionale neni 7.1 & 7.2 të FDT-se – Ftese për tender si në vijim:

OE-ik duhet të dorëzohet licenca për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leja mjedisore për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga Komuna e Prishtinës).

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Licensuar për Menaxhim të Mbeturinave ose Leje Mjedisore Komunale për Menaxhim të Mbeturinave

Pra kjo deshmon se **AK – ZPP me rastin e eliminimit të kompanis tone GOE per kete aktivitet te prokurimit dhe arsytimin tek letra standarde e eliminimi**, ka shkelur dispozitat ligjore te LPP-se, konkretisht **nenin 1, 2, 7, 24, 56 59, dhe 60te LPP-se**, andaj kerkojm fillimisht nga ZPP ne KpR te analizoje shfletoj te gjitha dokuemntet te cilat i kemi dorezuar me rastin e tenderimit per kete AP pasi qe kemi ofruar **LEJE MJEDISORE** ne pajtim te plote me kerkesen e percaktuar dosje Tenderit - **Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale**, per faktin se marr baze baze kerkesen me lart ashtu sic eshte kerkuar ne dosje Tenderit askund nuk specifikon se Leja Mjedisore duhet te jete “VALIDE” apo/ose me afat, qe do te thote se **AK – KOMISIONI I VLERESIMIT – Zyrtari Pergjegjes I Prokurimit** pran Komunes se Prishtine na ka **ELEMINUAR** ne shklje te nenit 56 par. 3 te LPP-se, per faktin se ne Dosje Tenderit nuk eshte kerkuar Leja mjedisore te jete me afat.....

Mirepo **AK – ZPP** me daten 20.03.2025 na drejtohet me letere standard per sqarime duke e ndryshuar edhe kerkesen e Dosjes se Tenderit duke Shtuar Fjalen **“DUHET TE JETE VALIDE”** duke ndryshuar kriteret e perzgjedhjes – Kerkesat mbi pershtateshmerin profesionale gjate fazes se vleresimit, duke na diskriminuar dhe eliminuar padrejtesisht dhe ne shkleje te kriterëve te perzgjedhjes ne DT

- PROVE: DT dhe letrat standard e sqarimit e dates 20.03.2025

Bazuar ne keto fakte dhe argument konkrete konstatojme se ne jemi GOE te pergjegjshem ku kemi arrit te plotesojm te gjitha Kriteret e perzgjedhjes dhe po ashtu kemi tenderuar me cmimin me te ulete te pergjegjegjshem, mirepo **AK** ne shkelje te nneit 1, 6 dhe 7 te LPP-se, ndryshon kerkesat e dosjes se Tenderit vetem per ta Eleminuar GOE pasi qe nuk mund te gjeje menyra tjera fillimisht perms letres standard kerkon sqarime duke shtuar fjalen “duhet te jete valide” me pastaj me date 28.03.2025 I drejtohet edhe zyres Ligjore brenda Komunes se Prishtines per te prodhuar fakte dhe argument vetem e vetem ten a eliminj nga ky AP edhe perkunder se kemi plotesuar te gjitha kushtet dhe kriteret e perzgjedhjese ne DT hde kemi ofertuar me cmimin me te lire te Pergjegjshem

- Prove Opinonini i Zyres Ligjore

Duke marr per baze se GOE te cilet kemi tenderuar per kete AP ne kemi prezantuar - **Leje mjedisore Komunal 05-352/10-81474/23 dt. 18.05.2023 me nr. 01/48**, leshuar nga Sektpori I mbrojtje se mjedisit dhe efqences se energjis i Drejtorise per Urbanizem, pas konstatimeve te leshuara nga “Mendimi i komisionit profesional” I dates 11.05.2023 me **Aktvendimin 05 nr. 352/10-71474/26 te dates 15.05.2023** leshuar per OE: **“Eco Clean & Energy” perfaqesuar nga Muhamet Muçiqi** dhe sipas kesij aktvendim kjo leje nuk eshte percaktuar afatii vlefshmerise qe do te thote kjo leje eshte valide per faktin se ne nuk kemi pranuar asnje njoftimin mbi anulimin e kesaj leje apo per vazhdimin e saj apo diqka te tille.

Mirepo nese i Referohemi Rregullores per ndryshim e plotesim e Rregullores per Menaxhimine e Mbeturinave nr. 01-30/01-227581/2 te dates 01.12.2023 ather eksiton nje rregullore e re qe me automatizem e rrezon rregulloren me te vjeter pra rregullorja 01-030/01-161704/24 me 6.12.2024 e qe ka hyre ne fuqi me 1 janar 2025 konkretisht ne nenin 3 te kesaj rregullore shkruan qe afati eshte 3 vjeqar dhe prap ne e plotsojme edhe kete kriter siqe eedhe po e prezantojme nenin 3 te kesaj rregullore.

1. Paragrafi 1 i nenit 12, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Kjo leje zëvendëson licencën për menaxhimin e mbeturinave që më parë është lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Kjo leje lëshohet nga Komuna e Prishtinës dhe vlen për operim vetëm në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe ka afat të vlefshmërisë për një periudhë tre (3) vjeçare siç përcaktohet në legjislacionin përkatës në fuqi për lejet mjedisore. Leja mund të vazhdohet pas parashtrimit të kërkesës nga kompania përkatëse në Sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe energjisë eficiente.

PROV: RREGULLORJA E RE 01-030/01-161704/24 me 6.12.2024

Prandaj bazuar nete dispozite ligjore LEJA MJEDISORE te cilen e kemi prezantuar per kete AP ka vvlefshmeri deri ne 3 (tri) vite qe do te thote se Komuna e Prishtines me rastin e vendimit per leshimit te lejeve mjedisore per kompanin tone te dates 18.05.2025 Nuk ka pas rregullore apo legjislacion per rregullimin e kesaj fushe por eshte thirrur ne status, ligjin mbi Vetqeverisje locale, Ligjin mbi Mbeturina dhe vet Komuna e Prihtines nuk e percakton afatin e kesaj Leje qe do te thote se Leje e Mjedist e prezantuar nga ana jone eshte valide deri ne fund te viti 2026.

Pavaresishet kesaj validieti I lejse Mjedisore nuk ka qene kriter dhe kerkese e Dosjes se Tenderit, qe do thote se ne jemi OE I pergjegjshem dhe kemiplotesuar te gjitha kushtet dhe krteret dhe kemi tenderuar me cmimin me te ulet te pergjegjshem.

Ndersa Opinonin i Zyres Ligjore nga Komuna e Prishtines eshte I ndikuar dhe eshte ne shkleje te Rregullores per Menaxhimine e Mbeturinave nr. 01-30/01-227581/2 te dates 01.12.2023, pasi qe askund nuk thuhet se Lejet e me parshme te leshuar nga Komuna e Prishtines kane vlefshmeri per njeperiudh 1 vjecare, por thuhet kan vlefeshmeri 3 vjecare, perveq keesaj nese I referohemi Ligjit mbi Proceduren Administrative neni 81 qe sqaron se Ligjet dhe rregulloret kan fuqin retroactive por hyjne ne fuqi dhe vlejten per perudhen e ardhshme. Po ashtu, kjo deshmon se Komisioni I vleresimit – ZPP kan kerkuar OPINON dhe fuqia e opinionit ligjore eshte zero sepse edhe ashtu eshte nje opinion pa asnej baze ligjore dhe krejt ipa nevojshem dhe as qe duhet te merret per baze sepse perveq qe ne kemi arrit te plotesojm kerkesat e dosjse se Tenderit gjithashtu edhe Leja e Mjedisit e leshuar nga Komuna e Prishtiens te cilen e kemi bashkangjitur me rastin e tenderimit eshte me afat vlefshmerie dhe ploteson DT, Andaj kerkojm nga ZPP – Komisionii vleresimit te respektojn dispozitat ligjore te LPP-se dhe ten a rekomandojn per dhenie te kontates si tendruet me cmimim me te ulet te pergjegjshem.

AK komuna e prshlines me rastin e rekomandimit te GOE NITI – N SHPK, Clean Work Shines SHpk Garde De Capital SHPK – Prishtin per Lot 2

Antari i grupit Niti – N Shpk e ka prezantuar Ljeen mjedisore ashtu sikurse ne pa vlefshemri te afatiti e leshuar me date 18.04.2023 vetem 3 muaj para dates se Leje Mjedsiore qe kemi dorezuar ne ky Vperim I AK – ZPP – Komisionit te vleresimit eshte diskriminues dhe favorizuar ne raport me oferten tone duke demtuar buxhetin duke rekomanduar nje OE me cmimin me te lart se sa oferta jone. Ndersa Leja Mjedisore nga OE Clean Work Shines SHPKka dorzuar leje mjedisore komunale per trajtimin e mbeturinave ndertimore qe nuk korospondon me ate qfar eshte kerkuar ne dosje te tenderit.

V E N D I M
PËR LEJE MJEDISORE KOMUNALE

- I. MIRATOHET kërkesa për Leje Mjedisore Komunale 05-352/10-75223/24 dt. 11.06.2024, e kërkesit – “Clean Work Shines” sh.p.k. me adresë: Rr. “24 Maji”, Prishtinë, përfaqësuar nga Xhevrije Gashi nga Prishtina, për deponimin e përkohshëm dhe trajtimin e mbeturinave ndërtimore. Lokacioni ku janë të vendosura makineritë për zhvillim të aktivitetit gjendet në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-71914020-01944-1 ZK Grashticë, me pronar Behram Gashi nga Prishtina.
- II. Hartimin e dokumentacionit ndërtimor - elaboratin për Leje Mjedisore Komunale për deponimin e përkohshëm të mbeturinave ndërtimore, magazinimin e mbeturinave dhe bartjen e tyre deri në Deponi nga pika I. e këtij Vendimi e ka punuar Fatlume Murati – Msc i biologjisë, nga Prishtina.
- III. Në kuadër të elaboratit nga paragrafi II. i këtij vendimi është prezantuar dhe gjendja e terrenit të lokacionit.
- IV. Leja Mjedisore Komunale ka afat të vlefshmërisë për periudhën një (1) vjeçare.

Andaj duke ju referuar lejes mjedisore të leshuar nga komuna e prishtinës për CLEAN WORK SHINES SHPK nuk perputhet me dosjen e tenderit që në dosjen e tenderit kërket : OE-ik duhet të dorëzohet licenca për menaxhimin e mbeturinave (e leshuar nga ministria përkatëse) ose leja mjedisore për menaxhimin e mbeturinave (e leshuar nga ministria përkatëse) ose leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave (e leshuar nga Komuna e Prishtinës). - *Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Licensuar për Menaxhim të Mbeturinave ose Leje Mjedisore Komunale për Menaxhim të Mbeturinave

PROVË: LEJA MJEDISORE E LESHUAR PËR CLEAN WORK SHINES SHPK

Po ashtu ka dorëzuar për shpalljen e fitimit dokumentin e gjykates për aplikim në kredi e cila nuk vlen për asgjë tjetër vetëm për aplikim në kredi gjë që tregon që GOE është totalisht i pa përgjegjshëm dhe vërtetimi nga gjykata nuk korrespondon me kërkesën e DT që normalisht duhet të jetë APLIKIM PËR TENDER DHE JO APLIKIM PËR KREDI

E njëjta është kërkuar nga pala me qëllim të pjesëmarrjes në Kredi dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera. *Ista je zatražena od strane s ciljem učesća za Kredit, i ne može se upotrebiti za druge svrhe.*

PROVË: DOKUMENTI I DORZUAR NGA CLEAN WORK SHINES SHPK VERTETIM I GJYKATES PËR SHPALLJEN FITUES

Gjithashtu nuk poëdojnë Listën kontratëve dhe referencave pasi që nuk arrijnë vlerën për 900,000.00 euro nuk plotësojnë këto kapacitete teknik dhe profesionale që do të thotë janë të papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohen prandaj në jemi dikriminuar dhe eliminuar padrejtësisht në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-se. Pasi që kompania **garde de capital shpk** ka referencë për pastrimin të hapsirave të brendshme dhe nuk e plotson kërkesën e FDT.

Po ashtu Ju mungojnë edhe makineritë dhe pajisjet e kanit prezantuar pa Librezë qarkullimi valide dhe ju mungojnë edhe pasat ashtu siç është kërkuar në Dosjet tenderit janë të papërgjegjshëm

Gjithashtu nuk e plotësojnë Listën e pajisjeve profesionale të OE ku për kërkesën **Kamionë me peshë totale ≤7000 kg ka dorëzuar kamionet që nuk i plotson kërkesën pasi kërkesa ka qenë kamion dhe jo kamionet (01-537 – PD) po ashtu është kërkuar Kamion për larje me peshë bartëse ≥ 9,000l, dhe me nivel të emetimit të gazrave Euro 3 apo teknologji më të avancuar GOE ka prezantuar Kamion me peshë bartëse 6260 (01-842-UO) që as për se afërmi nuk i plotson kriteret e Dosjes së tenderit.**

AK Komuna e Prishtines me rastin e rekomandimit te GOE Selmans Networl shpk ; Via Shpk; – Prishtin per Lot 1

Gjithashtu nuk poedojn Listene kontratev dhe referencave pasi qe nuk arrijn vleren per 900,000.00 euro nuk plotesojn keto kapacitet teknik dhe profesionale qe do te thote jane te papergjegjshem dhe duhet te elemniohen prandaj ne jemi dikriminuar dh eeliminuar padrejtesisht ne shkelje te dispozitave ligjore te LPP-se.

Marveshjen e konserciumit se kane sipas dispozitave qe i cakton ligji

Po ashtu Ju mungojn edhe makinerit dhe paisjet I kan prezantuar pa Libreza qarkullimi valide dhe ju mungojn edhe pasha ashtu sic eshte kerkua ne Dosje tendeit jane te papergjeshem

GOE nuk e plotson Aneksin 6 ku jane lista e paisjeve profesionale

1. Kamionë me peshë totale ≤7000 kg – Mungojne 2 copa

3. Kamionë me peshë totale 18000-27000 kg – Mungojne 4 copa

4. Kamionet special për bartjen e mbeturinave prej 1.5 në 4.5 ton, - mungon 1 cope

5. Kamion për larje me peshë bartëse ≥ 9,000l, dhe me nivel të emetimit të gazrave Euro 3 apo teknologji më të avancuar – Mungon GOE ka prezantuar nje cistern naftes me marveshje me EUROKOS PETROL – 05-244-FE qe nuk korospodon me kerkesen ne dorjen e tenderit

Gjithashtu, ne perveq qe kemi tenderuar ne pajtim te plote me te gjitha kriteret e perzgjedhjes te percaktuar ne dosje tenderit, po ashtu duke plotesuar Aneksin 7 me dokumentet relevante dhe deshmi konkret, NE kemi tenderuar edhe me çmimin mem te ulet te pergjegjshem duke vendosur çmimin me te ulete se sa GOE te rekomanduar per kontrat Me kete veprim AK – ZPP ka shkelur parimin keryer te prokurimit **“VLEREN PER PARA”** me rastin e elmnimit tone dhe rekomandimin e GOE per dhenie te kontrate, duke demtur Buxhetin e Komunes dhe te Republikes se kosove, pasi qe ka rekomanduar nje GOE te papergjeshem si dhe ne ka eliminuar NE si GOE me cmiminmete ulet te pergjegjshem

Provë: Pershkrimi i Cmimeve te dorezuar nga ana jone – Procesverbali i hapjes.

Ne mbesim em shpresen se AK – ZPP do te reflektojn dhe te shterrin te gjitha mundesit ligjore te cilat jane te parapar me dispozita ligjore te LPP-se, dhe te sigurohen dhe te konstatojn se NE si GOE jemi te pergjegjsehm dhe plotesojm kushtet dhe kriteret e dhenies sipas dosjese se tenderit dhe njoftimit per kontrate

Shkeljet nga AK me rastin e nxjerrres se Vendimit mbi refuzimin e KpR ne shkelje te nenit 108/A te LPP-së.

AK me keteo veprim te ndermarr ne kete AP te neguciuar permes platformes elektronike e-prokurim ka deshmuar me fakte dhe prova konkret se nuk ka repsektuar dispozitat ligjore te LPP-se te potencuar me larte pa pasur nevoj te sqarome perseri, pasi qe edhe perkunder argumentimit toen ne KpR perseri vazhdon em shkeljet e nenit 1, 6, 7, 24, 56, 59 dhe 60 te LLP-se si dhe ne shkelje te nenit 108/A te LPP-se, konkretisht par. 8 dhe 12 duke mos dhene asnje prov dhe arument te bazuar ne kriteret e perzgjedhes te percaktuar ne DT , si dhe duke zvarritur shuem gjate vleresim e ketij AP kur dihet se ka qene procedure e enegucuar dhe emergjent keto fakte dhe prova deshmoj se AK sillet sikurse ne procedur te hapur dhe vonon gjate vleresimin dhe i cili eshte ne shkelje flagrte te dispozitave ligjore te LPP-se, duke demtuar edhe interesin publik dhe interesin tone material.

Gjithashtu, ja rikujtojm AK se edhe perkunder se vete ka percaktuar kriteret e perzgjedhjes dhe parimisht esht dashur te dij te vleresoj tenderin ne pajtim te plot pa pasur nevoj per sqarime dhe OPINONE nga nje organ tjetër – zyra ligjore po ashtu eshte dashur te kete parasysh nenin 134 par. 1, 2 dhe 3 te LPP-se, po ashtu Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE lidhur me ndryshimin e legjive dhe rregulloreve per procedura dhe Licenca qe kane marr fuqin juridike ne kohen e leshimit sipas rregulloreve ne fuqi duke marr per baze afatet kohore dhe jo te ne elemion ne shkelje te nenit 56 te LPP-së.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me **nenin 59 LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesorë për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas **nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së**.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe “*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe **nenin 1 te LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosoves.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga ESH dhe OSHP qe te merr:

VENDIM

APROVOHET, - si e bazuar Ankesa prane OSHP-së nga GOE: **ANUAR SH.P.K.; MUHAMET MUCIQI; BERISHA COM SHPK**

ANULOHET, - njoftimi mbi vendimin e AK-se për dhenie te kontrates dhe lënda te kthehet ne **RIVLERESIM, -** Autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te bëhet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave te LPP-së. **Per LOT 1 dhe PER Lot 2**

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente, dhe do te kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga te gjithëpalët qe kane marr pjesë ne këtë aktivitet te prokurimit

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkëlja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

DEMET MATERIALE JANE TE MEDHA NE PERGATITJEN E KETI TENDERI KONKRETISHT KPR NE VLERE **750.00 EURO** DEME TJERA MATERIALE JANE 30 PUNTORE TE PUNESUAR ANGAZHUAR PER KETE PROJEKT MUND TE MBESIN PA PUNE SI DHE DEME TJERA MATERIALE JANE 10 % E FITIMIT TE HUMBUR NGA KY PROJEKT SEPSE NE OPEROJME NE KETE FUSHE TE KESAJ NATYRE TE PROKURIMIT

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

B47-Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

20.03.2025

**Grup i Operatorëve Ekonomik ANUAR SH.P.K.; Muhamet Muçiqi;
BERISHA COM SH.P.K., prishtin llukar, 100000, prishtin**

Nr i prokurimit	616-25-1133-2-1-5
Nr i brendshëm	616-25-031-2-1-5

Titulli:Ofrimi i shërbimit të grumbullimit ,transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontratë e negociuar

Të nderuar/a;

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “ LPP ”.

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Ju me ofertën tuaj keni dorëzuar:Leje mjedisore 2023. Autoriteti Kontraktues kërkon sqarime nga ju si ne vijim:

Pyetja nr. 1.

OE-ik duhet të dorëzohet licenca për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leja mjedisore për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga Komuna e Prishtinës).

Dëshmia e kërkuar:

Licensuar për Menaxhim të Mbeturinave ose Leje Mjedisore Komunale për Menaxhim të Mbeturinave duhet të jete valide

Autoriteti Kontraktues Bazuar ne nenin 66, të LPP-se kërkojmë nga ju qe gjatë sqarimit të tenderit duhet të dorëzoni dëshmitë e kërkuara si ne kërkesë të DT dhe njoftimin për Kontratë.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen përmes platformës se E-prokurimit deri me datë 23.03.2025 ora 16:00.

SHENIM: Ju lutem sqarimet ti dorëzoni përmes platformës. Mos ngarkoni dokumentet tek butoni “Sqarimet e dosjes se tenderit ” sepse tani jemi ne fazën e vlerësimit dhe ai buton tashme është

mbyllur. Butoni “Sqarimet e dosjes se tenderit’ përdoret gjate fazës se publikimit. Gjate fazës se vlerësimit ju duhet te ndiqni hapat e mëposhtëm për dorëzim te informatave shtese.

“OE duhet te shtyp butonin “prokurimet e mia”, përzgjedh aktivitetin për te cilin do te dorëzoj informatën shtese, dhe klikon ne butonin “dorëzo dokumentin tek AK”.

Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,
Me respekt Sektori i Prokurimit

Për: Autoritetin Kontraktues - Sektorin e Prokurimit – Komuna e Prishtines
Cc: z. Visar Shehu - Zyrtari Pergjegjes te Prokurimit - ZPP

Nga: Grupi i Operatorëve Ekonomik - ANUAR SH.P.K.; Muhamet Muçiqi;
BERISHA COM SH.P.K., Prishtin Llukar, 10000, Prishtina

Lënda: Përgjigje ne sqarimin -Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit B47t e dates 20.03.2025 te pranuar nga AK – Sektori I Prokurimit – Komuna e Prishtines

Datë: 21.03.2025

Te nderuar,

SQARIM: per SEKTORIN E PROKURIMIT DHE ZPP TE KOMUNES SE PRISHTINES

Fillimisht, sqarojme se duke marr per baze Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 7.1 dhe 7.2 te FDT-se – Dosjese se tenderit ku eshte kërkuar si ne vijim:

Përshtatshmëria profesionale:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
OE-ik duhet të dorëzohet licenca për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leja mjedisore për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga Komuna e Prishtinës).	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Licensuar për Menaxhim të Mbeturinave ose Leje Mjedisore Komunale për Menaxhim të Mbeturinave

Andaj, duke marr per baze kerkesen e dosjesn se tenderit ne kemi tendruar ne pajtim te plote me kete keres te FDT-se, per fkatim se kemi dorezuar **Leje mjedisore Komunal 05-352/10-81474/23 dt. 18.05.2023 me nr. 01/48**, leshuar nga Sektori I mbrojtjes se mjedisit dhe efiqences se energjis i Drejtorise per Urbanizem, pas konstatimeve te leshuara nga “Mendimi i komisionit profesional” I dates 11.05.2023 me **Aktvendimin 05 nr. 352/10-71474/26 te dates 15.05.2023** leshuar per OE: **“Eco Clean & Energy” perfaqesuar nga Muhamet Muçiqi** dhe sipas kesij aktvendim kjo leje eshte e perhershme pasi qe nuk ka nje date te skadimit e qe do te thote se eshte e perhershme dhe valide.

Po ashtu, kemi dorezuar **Leje mjedisore Komunal 05-352/10-143796/23 dt. 12.07.2023** leshuar nga Sektori i mbrojtjes se mjedisit dhe efiqences se energjis i Drejtorise per Urbanizem, pas konstatimeve te leshuara nga “Mendimi I komisionit profesional” I dates 11.05.2023 me **Aktvendimin 05 nr. 352/10-143796/26 te dates 12.07.2023** leshuar per OE: **“Anuar” Sh.p.k. perfaqesuar nga Nazif Krasniqi, Leje mjedisore komunale per institucionin transfer per magazinimin e mebeturinave dhe bartjen e tyre deri ne Deponi sipas ketij vendimi**, dhe sipas ketij aktvendim kjo leje eshte e perhershme pasi qe nuk ka nje date te skadimit e qe do te thote se eshte e perhershme dhe valide, ne pajtim te plote me kriteret e perzgjedhjes te percaktuar ne dokumentet e Tenderit – FDT-se (Dosjen e tenderi).

Marveshja e konsorciumit per kete aktivitet te prokurimit nga ana jone eshte ne pajtim te PLOTE me **nenin 71 te LPP-se**, ku jane sqaruar te gjitha detyrimet dhe pergjegjsit nga grupi yne per kete aktivitet te prokurimit, dhe AK me qellim te mos-diskriminimit te grupit tone ekonomik, si dhe ne pajtim te plote me nenin 66 dhe 67 te LPP-se, per faktin se AK ne dokumentet e tenderit nuk ka specifikuar se Leja mjedisore duhet te jete valide, ndersa ne **B47-Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e Tenderit**, te dates. 20.03.2025 tek deshmia e shton edhe fjalen "VALIDE" perkunder kesaj Leja mjedisore e dorzuar nga Grupi yne i operatorve ekonomik kemi dorezuar Leje Mjedisore me afat te perhershëm, pasi qe e aktevdimin e dokumentuar si me larte nuk specifikon/percakton periudhen e vlefshmerise qe do te thote se jane te perhereshem dhe jane valide ne pajtim te plote me kriteret e perzgjedhjes te percaktuar ne dokumentet e Tenderit – FDT-se (Dosjen e tenderi).

Gjithashtu, sqarojme se AK – Sektori I prokurimit ne **B47-Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e Tenderit**, te dates. 20.03.2025, nuk specifikon dhe nuk eshte I qarte lidhur me shtrimin e pytjes, I cili per ne eshte konfuz dhe I paqarte per faktin se thirret vetem ne nenin 66 te LPP-se, pa specifikuar konkretisht dhe pa definuar sakt kerkesen per sqarim. Ko per faktin se kerkesa ne FDT si me larte si dhe bazuar ne **nenin 26.5 dhe nenin 26.9 te RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

(Versioni i Konsoliduar), shuem qarte specifikon dhe argumenton se "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se", si dhe "Nëse lënda e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshinë ofrimin e shërbimeve profesionale dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën, mjafton që njëri anëtar i grupit të ketë autorizimin, apo mjafton që njëri anëtar i grupit të jetë i licencuar dhe të dorëzojë dëshminë së bashku me dokumentet tjera të tenderit të grupit të operatorëve ekonomik në mënyrë që të konsiderohet se grupi e ka përmbushë këtë kërkesë si tërësi".

Andaj, ne konisderojme se GOE yne ne kete aktivitet te prokurimit kemi tenderuar/ofertuar ne pajtim te plote me dispozitat ligjore te LPP-se duke arrit te ploteosjme ne ploteni kriteret e perzgjedhjes si dhe kriterin kryesor te dhenes se tenderit ne nenin 31.1 Tenderi i pergjegjshëm me **Çmimin më te ulët**, pra me fjale tjera ne jemi GOE te pergjegjshem per kete aktivitet te prokurimit duke plotesuar nenin 1, 7, 59 dhe 60 te LPP.

Ne inkualojme AK sektorin e prokurimit – ZPP qe nese akoma ka dilema lirisht te na drejtohet me **B47-Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e Tenderit**, per sqarimin e tenderit duke specifikuar konkretisht dilemat dhe paqartesit lidhur me dokumentet e tenderit tone per kete AP ne menyre qe te pergjegjemi dhe te sqarojm cdo dilem te parashtruar nga Komisioni i vlerësimit – ZPP dhe te deshmojme pergjegjshemerin tone per kete AP.

Lusim AK – Komisionin e vlerësimit – ZPP per cdo paqartesi lirsht te na shkruani ne menyre qe cdo dilem te sqarohet ne funksionimin e respektimit te dispozitave ligjore te LPP-se.

Ju faleminderit per mirëkuptim!

Me respekt!

GOE - ANUAR SH.P.K.; Muhamet Muçiqi; BERISHA COM SH.P.K., Prishtinë Llukar, 10000, Prishtina

Vula



Manush Gashi

From: Valmire Mustafa
Sent: 28 March, 2025 09:01
To: Manush Gashi
Subject: FW: Kerkese per Informate per Lejet mjedisore

From: Fatos Dibra <Fatos.Dibra@rks-gov.net>
Sent: Thursday, March 27, 2025 1:51 PM
To: Jehona Mavraj <Jehona.Mavraj@rks-gov.net>; Prokurimi Prishtine <prokurimi.prishtine@rks-gov.net>
Cc: Florent Maliqi <florent.maliqi@rks-gov.net>; Visar Shehu <visar.shehu@rks-gov.net>; Valmire Mustafa <valmire.mustafa@rks-gov.net>
Subject: RE: Kerkese per Informate per Lejet mjedisore

Lidhur me kërkesën tuaj për informate, i jemi referuar dispozitave të Ligjit nr.04/L-60 për mbeturina, i cili në nenin 25 përcakton mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin i mbeturinave, si dhe neni 34, përcakton:

1. Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, grumbullohen trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitave tjera ligjore për rregullimin e veprimtarive komunale.
2. Komunat, me akt nënligjor, përcaktojnë kushtet dhe rregullat për menaxhimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike”.

Ndërkaq, Ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-60 për mbeturina, me nenin 18, e ndryshon nenin 25 të Ligjit bazik, ndërkaq neni 39 i këtij Ligji përcakton:

1. Titulli i KREUT VIII, të ligjit bazik, “Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave”, zëvendësohet me titullin “Leja përkatëse Mjedisore”.
2. Titulli i nenit 55, të ligjit bazik, “Licenca për menaxhimin e mbeturinave” zëvendësohet me titullin “Leja Përkatëse Mjedisore”
3. Në nenin 55, të ligjit bazik, paragrafi 1, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: 1. Operatorët që menaxhojnë mbeturinat duhet të pajisen me leje përkatëse mjedisore.

Ndërsa, sipas nenit 34 të Ligjit bazik, me datë 01.12.2023, ka hyrë në fuqi Rregullorja Komunale 01-030/01-227581/23 për menaxhimin e mbeturinave, e cila në nenin 12 përcakton: “Kjo leje zëvendëson licencën për menaxhimin e mbeturinave që më parë është lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Kjo leje lëshohet nga Komuna e Prishtinës dhe vlen për operim vetëm në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe ka afat të vlefshmërisë për një periudhë një (1) vjeçare. Leja mund të vazhdohet pas parashtrimit të kërkesës nga kompania përkatëse në Sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe energjisë eficiente”.

Tani, duke u nisur nga fakti se lejet mjedisore të lëshuara për dy rastet në fjalë, janë të datave njëra 18.05.2023 dhe tjetra 18.08.2023, me afate kohore të pacaktuara, dhe duke u ndërlidhur me faktin se me datë 01.12.2023 ka hyrë në fuqi Rregullorja bazë e cila e përcakton afatin kohor 1 vjeçar për vlefshmërinë e lejeve mjedisore, rrjedhimisht i bie që afati i lejeve mjedisore atëkohë të poseduara kanë

pasur afat të vlefshmërisë 1 vit nga hyrja në fuqi e Rregullores dhe e drejta do të ishte që palët kërkuese në fjalë, pas kalimit të 1 viti nga hyrja në fuqi e Rregullores, të bëjnë kërkesë për vazhdimin e lejes mjedisore sipas dispozitave të Rregullores bazë, sepse ajo rregullore ka shfuqizuar rregulloren e mëparshme, sepse siç e përcakton edhe neni 12.2 i Rregullores bazë: “Në mënyrë që ti vazhdohet leja kompanisë përkatëse, e njehta duhet të raportojë rregullisht në Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë, në Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe ambientit në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, si dhe në Sektorin e mbrojtjes së Mjedisit dhe energjisë eficiente në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës”, që nënkupton se kompanitë në fjalë në vazhdimësi duhet të raportojnë dhe të jenë të përditësuar lidhur me procedurat e lejes mjedisore dhe çështjeve të tjera relevante me këtë çështje.

Me respekt,

Fatos DIBRA

Udheheqes i Sektorit Ligjor

Kabineti i Kryetarit

Komuna e Prishtinës

E-Mail: fatos.dibra@rks-gov.net

Tel: VoIP: +383 (0) 38 40081

From: Jehona Mavraj <Jehona.Mavraj@rks-gov.net>

Sent: 26 March, 2025 08:10

To: Fatos Dibra <Fatos.Dibra@rks-gov.net>; Prokurimi Prishtine <prokurimi.prishtine@rks-gov.net>

Cc: Florent Maliqi <florent.maliqi@rks-gov.net>; Visar Shehu <visar.shehu@rks-gov.net>; Valmire Mustafa <valmire.mustafa@rks-gov.net>

Subject: FW: Kerkese per Informate per Lejet mjedisore

Përshëndetje Fatos,

Po ju përcjell për interpretim dhe për përgjigje në pyetjen e parashtruar nga Zyra e Prokurimit, lidhur me vlefshmërinë e lejeve mjedisore të lëshuar nga Sektori I Mjedisit I D. së Urbanizmit,

duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të “Rregullore për menaxhimin e mbeturinave”, 01 Nr. 030/01-227581/23 dt. 01.12.2023, e miratuar nga Kuvendi I Kryeqytetit.

